



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**PROJEKT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“PREFEKTURËN SHKODËR”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“MBI PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË PREFEKTURËS SË**  
**QARKUT SHKODËR”**

**TIRANË, SHTATOR 2024**

<b>Përmbajtja</b>	
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
a. Përshkrim i shkurtër i institucionit .....	3
b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij. ....	3
c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: .....	3
d. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit: .....	3
e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve .....	4
<b>KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT</b> .....	<b>5</b>
<b>II. HYRJE</b> .....	<b>6</b>
1. Objektivat dhe qëllimi.....	6
2. Identifikimi i çështjes: .....	6
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: .....	7
4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:.....	7
5. Kriteret e vlerësimit: .....	7
6. Standardet e Auditimit .....	8
7. Metodatat e auditimit.....	8
8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit: .....	9
<b>III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT</b> .....	<b>9</b>
1. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT .....	9
2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, SI DHE ZBATIMI I KONTRATAVE TË PUNIMEVE.....	15
3. AUDITIM MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTEVE NORMATIVE, URDRHAVE E URDHËRESAVE ME KARAKTER NORMATIV TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE.....	21
<b>IV.GJETJE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>34</b>
A. MASA ORGANIZATIVE .....	34
B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE .....	38
C. MASA DISIPLINORE. ....	38

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit**

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave (Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike), në nivel qarku. Prefektura Shkodër përbëhet nga 5 Bashki, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz, Bashki të cilat janë të ndara sipas 33 Nj.A dhe 272 fshatrave, sipas ndarjes administrative, me një sipërfaqe territoriale 3,368.83 km<sup>2</sup>, Pyje e kullota 212,019 ha; Tokë bujqësore 46,115 Ha (Tokë arë 42,522 Ha, Dru frutor 3,593 Ha). Prefekti i qarkut Shkodër e ushtron detyrën bazuar në Ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe Rregullores së brendshme të funksionimit.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

Ky auditim ka rëndësi për arsye se, Prefektura Shkodër administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit. Auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndër marrë veprimet korrigjuese sipas rastit dhe të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie.

### **c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Qëllimi i këtij auditimi është nxjerja e konkluzioneve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe vendimmarrëse të Prefektit me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Prefektura Shkodër. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme

- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit publik.
- mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së Akteve Normative të nxjerra nga Këshillat Bashkiak.

### **d. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

*Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

*Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikuat me drejtimit e auditimit;

*Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Prefektura e Qarkut Shkodër për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 9 gjetje dhe janë lënë 10 rekomandime.

#### **f. Gjetjet kryesore:**

Dokumentimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” bëhet në mënyrë tepër formale pa përcaktuar kritere kualifikimi dhe specifikime teknike, pa shpallje fituesi dhe përcaktimi të vendit dhe datës së kryerjes së dorëzimit të mallrave e shërbimeve, apo pa u shoqëruar me argumentimin e detajuar të nevojës për shpenzime. Ndër rastet e trajtuara ka copëzim të fondit për blerje të të njëjtës natyrë, kryesisht ato me vlerë nën 100,000 lekë për të cilat është shmangur realizimi i procedurës përkatëse me mjete elektronike;

- nga 46 VKB të pa konfirmuara nga Prefekti i Qarkut për periudhën 2022-2023, vetëm në 3 raste janë rikthyer pranë Prefektit Vendimet e rishqyrtuara nga Bashkitë, ndërkohë që për 43 të tjera Prefekti i Qarkut nuk ka marrë masa për ndjekien e mëtejshme të tyre dhe nuk konstatohet të jetë shprehur për këto Vendime as gjatë procesit të verifikimit në vend.
- janë konfirmuar akte normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe konkretisht në 9 raste, procesverbale të mbledhjeve të KB të parregullt ku vihet re se nuk korrespondon numri i anetarëve të KB në listëprezencë me numrin e atyre që kanë votuar apo me numrin e nënshkruesve në fund të procesverbaleve. Në 11 raste akte normative për dhënie pronash në përdorim apo heqie nga fondi kullor pa certifikatë pronësie dhe pa statusin juridik të pronës nga AShK, si dhe në 9 raste pa shoqëruar me plan vendosje të sipërfaqeve. Po kështu për rastet e vendimmarrjeve mbi ronat u konstatua në 7 raste miratime pa realizuar konsultimin publik me komunitetin;
- është konfirmuar ligjshmëria e një vendimi i cili ka dëmshpërblyer përfituesin duke u trajtuar me kuadrin ligjor në fuqi për ndërtimin nga fillimi të banesës, ndërkohë që referuar certifikatës së pronësisë sipërfaqja e dëmtuar është vetëm një pjesë e sipërfaqes totale të objektit.
- në 20 raste janë marrë vendime për dhënie për shfrytëzim apo përdorim të pasurive publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

#### **g. Rekomandimet më kryesore për përmirësimin e situatës:**

- Njësia e Prokurimit pranë Prefekturës Shkodër të marrë masa për shmangien e copëzimit të fondeve për kryerjen e shpenzimeve me natyrë të njëjtë, duke planifikuar me saktësi nevojën dhe argumentimin e hollësishëm për të tilla shpenzime dhe kryerjen e prokurimit të tyre në një procedurë të vetme e cila të garantojë konkurrencën dhe transparencën në realizimin e shpenzimeve.
- Prefekti i Qarkut Shkodër në cilësinë e të vetmit institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore, të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj Bashkive në respektimin hap pas hapi të procedurave që ndiqen për konfirmimin e akteve normative, si dhe të mbajë korrespondenca me Bashkitë për dokumentimin e rasteve kur këto të fundit nuk do të vijojnë me miratimin e akteve të refuzuara nga prefekti.
- Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga Bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimmarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore kur jepet në përdorim apo shfrytëzim një pasuri publike. Gjithashtu, të kërkohet nga Bashkitë që i gjithë dokumentacioni i dërguar nga Bashkitë të jetë i inventarizuar dhe me listën e dokumentacionit që përmban dosja.

- Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa për shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave që kanë ndjekur Bashkitë në çështjet e dhënies në përdorim, tjetërsimit apo kalimit në pronësi të pasurive publike, duke mos u mjaftuar vetëm me faktin se baza ligjore është cituar në vendime dhe relacione, por të verifikohet edhe në mënyrë të dokumentuar se janë ezauruar të gjitha këto përcaktime ligjore, përpara vendimmarrjes për përfundimin e procesit.
- Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa për rikthimin për shqyrtim të rasteve të akteve normative të cilat kanë mospërputhje në dokumentacionin e dërguar, si dhe nuk garantojnë siguri të arsyeshme nëse është aplikuar baza e duhur ligjore.
- Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa që në të ardhmen, gjatë periudhës 4 mujore të fushatave zgjedhore, të rikujtojë Bashkitë, si dhe të mos pranojë për shqyrtim asnjë akt normativ, vendimmarrja e të cilit nuk ka lindur nga nevojat e rasteve të emergjencave apo parashikimeve të tjera në ligj.

## KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinionin mbi përputhshmërinë.**

Ne kemi audituar përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e nevojave për shpenzime, procedurat e prokurimit publik, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së akteve normative të Këshillave Bashkiak. Bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Prefekturës së Qarkut Shkodër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar**.

### **Baza për opinionin:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- konstatohet se dokumentimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” bëhet në mënyrë tepër formale pa përcaktuar kriteret kualifikimi dhe specifikime teknike, pa shpallje fituesi dhe përcaktimi të vendit dhe datës së kryerjes së dorëzimit të mallrave e shërbimeve, apo pa u shoqëruar me argumentimin e detajuar të nevojës për shpenzime. Ndër rastet e trajtuara ka copëzim të fondit për blerje të të njëjtës natyrë, kryesisht ato me vlerë nën 100,000 lekë për të cilat është shmangur realizimi i procedurës përkatëse me mjete elektronike;
- nga 46 VKB të pa konfirmuara nga Prefekti i Qarkut për periudhën 2022-2023, vetëm në 3 raste janë rikthyer pranë Prefektit Vendimet e rishqyrtuara nga Bashkitë, ndërkohë që për 43 të tjera Prefekti i Qarkut nuk ka marrë masa për ndjekjen e mëtejshme të tyre dhe nuk konstatohet të jetë shprehur për këto Vendime as gjatë procesit të verifikimit në vend. Gjithashtu konstatohet se nuk ka një korrespondencë të dokumentuar me Bashkitë nëse këto vendime janë anuluar dhe nuk do të vijohet me miratimin e tyre;
- janë konfirmuar akte normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqëruar dhe konkretisht u konstatuan në 9 raste, procesverbale të mbledhjeve të KB të parregullt ku vihet re se nuk korrespondon numri i anetarëve të KB në listëprezencë me numrin e atyre që kanë votuar apo me numrin e nënshkruesve në fund të

procesverbaleve. U konstatuan në 11 raste akte normative për dhënie pronash në përdorim apo heqje nga fondi kullor pa certifikatë pronësie dhe pa statusin juridik të pronës nga AShK, si dhe në 9 raste pa shoqruar me plan vendosje të sipërfaqeve. Po kështu për rastet e vendimmarrjeve mbi ronat u konstatua në 7 raste miratime pa realizuar konsultimin publik me komunitetin;

- është konfirmuar ligjshmëria e një vendimi i cili ka dëmshpërblyer përfituesin duke u trajtuar me kuadrin ligjor në fuqi për ndërtimin nga fillimi të banesës, ndërkohë që referuar certifikatës së pronësisë sipërfaqja e dëmtuar është vetëm një pjesë e sipërfaqes totale të objektit.
- Gjatë vitit 2023, në 20 raste janë marrë vendime për dhënie për shfrytëzim apo përdorim të pasurive publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 566/1 Prot, datë 31.05.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.06.2024 deri më datë 05.07.2024 në subjektin Prefektura Shkodër, u krye auditimi mbi përputhshmërinë për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R. K, Përgjegjëse grupi
2. I. Sh, Audituese
3. E.K, Audituese

### **1. Objektivat dhe qëllimi**

Auditimi i përputhshmërisë është vlerësimi i pavarur nëse një çështje e caktuar e shqyrtuar është në përputhje me kornizën rregullatore të zbatueshme të identifikuar si kriteret. Auditimet e përputhshmërisë realizohen për të vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën rregullatore , i cili qeverisë njësinë e audituar”. Objektivi i këtij auditimi është identifikimi i devijimeve dhe dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, ngjarjet ekonomike dhe vendimmarrja e Prefekturës Shkodër janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe logaritimit.

Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

Titullari i institucionit, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe vendimmarrjen sa i takon verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative të njësive vendore në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

### **4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Prefekturës, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 107/2016, “Për Prefektin”

#### Standarde

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;

Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;

Manuali i zbatimi të rekomandimeve të KLSH;

Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

#### Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

#### Në fushën e prokurimeve publike

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar

#### Të tjera

Ligji nr. 8744, datë 22.01.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”;

Udhëzimi nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”;

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;

VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose të tjera shkaktuar nga veprimtaria njerëzore;

Ligji nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”

## **6. Standardet e Auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

## **7. Metodatat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

- a. *Metoda "Testim hap pas hapi"*: Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësitë publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.



- b. *Metoda e inspektimit fizik*: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.
- c. *Metoda e intervistimit*: Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashkrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.
- d. *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

### **8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjyqimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

## **III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

### **1. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 1, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit për periudhën 2022-2023, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- Vendimet "Për miratimin e buxhetit" për periudhë 2022-2023;
- Vendime në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për periudhë 2022-2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për periudhë 2022-2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

### 1. Programimi dhe realizimi i buxhetit 2022-2023

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **51,064** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **35,882** mijë lekë, ose në masën **70%**, ndërsa për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **50,231** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **45,479** mijë lekë, ose në masën **91%**.

Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelat në vijim.

*Tabela nr. I.1.1: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022*

<b>Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Prefektura Shkodër, për vitin 2022, në mijë lekë</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i shpenzimeve</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Fakti 2022</b>	<b>Realizimi në %</b>
1	Artikulli - 600 Paga	23,714	23,638	100%
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	3,982	3,933	99%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	6,465	4,998	77%
4	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	543	543	100%
5	Artikulli - 230 Projekte	5,000	0	0%
6	Artikulli - 231 Investime	11,360	2,770	24%
<b>TOTAL viti 2022</b>		<b>51,064</b>	<b>35,882</b>	<b>70%</b>

*Burimi: Prefektura Shkodër*

*Tabela nr. I.1.2: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023*

<b>Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Prefektura Shkodër, për vitin 2023, në mijë lekë</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i shpenzimeve</b>	<b>Plani 2023</b>	<b>Fakti 2023</b>	<b>Realizimi në %</b>
1	Artikulli - 600 Paga	32,500	31,316	96%
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	5,405	5,189	96%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	7,521	5,024	67%
4	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	301	295	98%
5	Artikulli - 230 Projekte	400	0	0%
6	Artikulli - 231 Investime kap 3+4	4,104	3,656	89%
<b>TOTAL viti 2022</b>		<b>50,231</b>	<b>45,479</b>	<b>91%</b>

*Burimi: Prefektura Shkodër*

Nga prefektura ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë prefektura, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, është sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47<sup>1</sup>, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44<sup>2</sup>, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c.

<sup>1</sup> Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse përndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin evitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

**2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura**

Rezultoni se buxheti i viteve 2022-2024 dhe 2023-2025 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

*Tabela nr. I.2.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022*

Planifikimi i të ardhurave 2022 prog 1160+1170 sipas PBA 2022-2024		Planifikimi i shpenzimeve 2022 prog 1160+1170 sipas PBA 2022-2024	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022		Art. 600 Paga	25,930
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2022		Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	4,126
<b>Total të ardhurat e veta</b>		Art.602 Shpenzime operative	7,613
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.		Art.604 Transferime korrente te brendshme	
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).		606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	100
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2022	46,913	Art.230-231 Investime	9,145
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2022		Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	46,913		
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>46,913</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>46,913</b>

*Burimi: Prefektura Shkodër*

*Tabela nr. I.2.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023*

Planifikimi i të ardhurave 2023 prog 1160+1170 sipas PBA 2023-2025		Planifikimi i shpenzimeve 2023 prog 1160+1170 sipas PBA 2023-2025	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023		Art. 600 Paga	26,255
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023		Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	4,385
<b>Total të ardhurat e veta</b>		Art.602 Shpenzime operative	8,416
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.		Art.604 Transferime korrente te brendshme	
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).		606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	110
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	47,838	Art.230-231 Investime	8,673
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2023		Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	<b>47,838</b>		
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>47,838</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>47,838</b>

Burimi: Prefektura Shkodër

Tabela nr. I.2.3: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2022

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 prog 1160+1170				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 prog 1160+1170			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar,	Buxheti shtesë/pakësim,	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar	Buxheti shtesë/pakësim,	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1+2</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>3+4</b>
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022				Art. 600 Paga	25,324	-1,610	23,714
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2022				Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,042	-60	3,982
<b>Total të ardhurat e veta</b>				Art. 602 Shpenzime operative	7,212	-747	6,465
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar				Art. 604 Transferime korrente të brendshme			
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	123	+420	543
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022				Art. 230-231 Investime			
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2022				Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)		+16,360	16,360
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>36,701</b>	<b>+14,363</b>	<b>51,064</b>				
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>36,701</b>	<b>+14,363</b>	<b>51,064</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>36,701</b>	<b>+14,363</b>	<b>51,064</b>

Burimi: Prefektura Shkodër

Tabela nr. I.2.4: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023 prog 1160+1170				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023 prog 1160+1170			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar,	Buxheti shtesë/pakësim,	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar	Buxheti shtesë/pakësim,	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1+2</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>3+4</b>
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023				Art. 600 Paga	25,390	+7,110	32,500
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023				Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4213	+1,192	5,404.9
<b>Total të ardhurat e veta</b>				Art. 602 Shpenzime operative	6500	+1,021	7,521
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar				Art. 604 Transferime korrente të brendshme			
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	200	+101	301

Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023				Art. 230-231 Investime		+4,504	4,504
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023				Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)			
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>36,303</b>	<b>+13,927</b>	<b>50,230</b>				
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>36,303</b>	<b>+13,927</b>	<b>50,230</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>36,303</b>	<b>+13,928</b>	<b>50,231</b>

*Burimi: Prefektura Shkodër*

### **3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit**

Nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022” dhe Ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023” Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër ka përgatitur raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit si vijon:

Për vitin 2022;

- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e I-të për vitin 2022 dërguar në MB me shkresën nr. 311/2 Prot., datë 10.05.2022;
- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e II-të për vitin 2022 dërguar në MB me shkresën nr. 639/2 Prot., datë 30.09.2022;
- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e III-të për vitin 2022 dërguar në MB me shkresën nr. 88/2 Prot., datë 24.01.2023.

Për vitin 2023;

- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e I-të për vitin 2023 dërguar në MB me shkresën nr. 359/2 Prot., datë 15.05.2023;
- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e II-të për vitin 2023 dërguar në MB me shkresën nr. 460/2 Prot., datë 11.09.2023;
- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e III-të për vitin 2023 dërguar në MB me shkresën nr. 121 Prot., datë 26.01.2024.

### **Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve**

Në Prefekturën Shkodër për vitin 2022 ka pasur një vendim gjyqësor për largim të pa drejtë nga puna, me Vendim nr. 234, datë 17.06.2022 në vlerën 982,464 lekë paguar gjatë vitit 2022 dhe për vitin 2023 nuk ka detyrime të prapambetura duke rezultuar në vlerën 0 lekë deri në 31.12.2023, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1,

Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

#### ***4. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.***

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Prefekturën Shkodër bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për vitin 2022 të ardhurat nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër janë nga, Depozitime të tjera në ruajtje në vlerë 846,450 lekë, të ardhura nga taksa e akteve dhe pullës në vlerë 44,550 lekë dhe të tjera të ardhura në vlerë 1,000 lekë, në total 892,000 lekë, të cilat janë me pjesëmarrje 100% nga Institucioni.

Për vitin 2023 të ardhurat nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër janë nga, Taksa e akteve dhe e pullës në vlerë 30,750 lekë, nga shitja e mallrave e shërbimeve 127,666 lekë, të tjera të ardhura 1,000 lekë dhe nga shitja (mjet transporti) në vlerë 272,537 lekë, në total 431,953 lekë.

#### ***5. Verifikimi i masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile për masat e marra për fatkeqësitë natyrore si tërmetet, përmbytjet, dëmtimet nga zjarri, vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë e ndryshme për përmirësimin e cilësisë jetës njeriut duke promovuar përvojat më të përparuara dhe shërbime të sigurta dhe efikase.***

Struktura përgjegjëse për emergjencat dhe mbrojtjen civile pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër është Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave (SPPECK), i cili funksionon bazuar në Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”. SPPECK në fillim të çdo viti harton “Planin e punës vjetor” dhe mbi bazën e tij harton planet mujore.

- Gjatë vitit 2022 SPPECK ka hartuar planin e masave me shkresë nr. 263/3 prot., datë 26.04.2022, “Për parandalimin, menaxhimin dhe organizimin e operacioneve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota në territorin e Qarkut Shkodër”, dhe në muajin Korrik të 2022 ka përfunduar aderimi i planit nr. 263/2 prot., datë 26.04.2022 në përmbushje të Ligjit 45/2019, “Për mbrojtjen civile”;
- Gjithashtu janë mbajtur takime të vazhdueshme me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Institucionet që janë pjesë e KMCQ, duke informuar në mënyrë konstante për situatën në territorin e Qarkut Shkodër;
- Gjatë muajit Tetor është organizuar mbledhje me qëllim marrjen e masave për emergjencat sezonale në periudhën vjeshtë – dimër 2022-2023 dhe është hartuar plani i masave me shkresën nr. 611/10 prot., datë 17.10.2022 “Për përballimin e situatave emergjente sezonale (vjeshtë – dimër 2022-2023)”;
- Gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022, janë organizuar në mbështetje të kërkesave të Bashkive, procesi i shpërndarjeve të pakove si pasojë e reshjeve të dendura të shiut nga përmbytjet, si dhe strehim i përkohshëm i banorëve që kanë patur prezencë të lartë të ujit nëpër shtëpi;

- Gjatë vitit 2023, janë hartuar kryesisht plane, seminare, trajnime dhe monitorimin e situatave të emergjencave lokale si zjarre dhe izolimin nga dëbora, si dhe takime të vazhdueshme me bashkitë ose inspektime në terren;
- Në takimet e organizuara nga SPPECK janë hartuar plane për emergjencat e zjarreve, emergjencat sezonale dhe përmytjet. Gjithashtu janë bërë seminare, workshop dhe trajnime në kuadrin e projekteve dhe mbështetjes së bashkive.

## **2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, SI DHE ZBATIMI I KONTRATAVE TË PUNIMEVE**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 566/1, date 31.05.2024, i ndryshuar, pika 2, u auditua mbi planifikim dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2023. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2022-31.12.2023;  
 Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;  
 Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;  
 Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01.01.2022-31.12.2023) u konstatua se; Autoriteti Kontraktor (Prefektura Shkodër ka realizuar gjithsej; Për vitin 2022, janë parashikuar 20 procedura prokurimi me fond limit 2,192,109 lekë dhe janë realizuar 15 blerje me vlerë fondi limit për 1,750,443 lekë, për të cilat edhe ka lidhur 15 kontrata me vlerë 1,294,354 lekë; Të gjitha procedurat e realizuara janë blerje me vlerë të vogël, ose nën vlerën prej 100,000 lekë.

Për vitin 2023, janë parashikuar 21 procedura prokurimi me fond limit 2,709,163 lekë dhe janë realizuar 18 blerje me vlerë fondi limit për 2,508,330 lekë, për të cilat edhe ka lidhur 18 kontrata me vlerë 2,045,929 lekë. Të gjitha procedurat e realizuara janë blerje me vlerë të vogël, ose nën vlerën prej 100,000 lekë.

Me analizë të hollësishme për blerjet e realizuara me procedurë “Vlerë e vogël”, për secilin urdhër prokurimi dhe urdhër shpenzim në periudhën raportuese ushtrimore, periudhë objekt auditimi në lidhje me dokumentacioni autorizues dhe vërtetues bashkëlidhur procedurës së prokurimit e urdhër shpenzimit në mënyrë kronologjike u për zgjodhën dhe u konstatua sa më poshtë;

### **Për vitin 2022**

Është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me nr. 02 Prot., datë 05.01.2022 me përbërje si vijon:

Z. A. T – Kryetar

Zj. F. Z. – Anëtare

Zj. A. H – Anëtare

Me urdhër nr. 03 prot., datë 05.01.2022 është krijuar komisioni për pritjen e mallit dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve për procedurat e blerjes me vlerë të vogël për vitin 2022 me përbërje:

Z. V. G – Kryetar  
Z. A. I – Anëtar  
Z. E.R – Anëtar  
Zj. E. K – Anëtare

1. Me shkresë nr. 917, datë 12.12.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Blerje dokumentacioni”, me urdhër prokurimi nr. 24, datë 12.12.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 12.12.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 83,060 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 521/2022, datë 16.12.2022, Proces Verbali i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 16.12.2022.

Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 195, datë 19.12.2022 është likuiduar subjekti subjekti “L.M PF” për vlerën 98,400 lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike kryesisht për mallrat të llojit broshura me info për katastrofat, apo fletë palosje mbi zjarret, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 16.12.2022 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifikimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Me shkresë nr. 918, datë 13.12.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik”, me urdhër prokurimi nr. 25, datë 13.12.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 13.12.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 83,240 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 520/2022, datë 16.12.2022, likujduar në vlerën 97,320 lekë me tvsh për L.M PF. Proces Verbali i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 16.12.2022.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike kryesisht për mallrat të llojit kartolina, apo stilo e personalizuar, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 16.12.2022 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifikimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Me shkresë nr. 409, datë 22.06.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Krijim dhe publikim i materialeve të shtypura”, me urdhër prokurimi nr. 13, datë 22.06.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 22.06.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 82,500 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 223/2022, datë 14.07.2022, likujduar në vlerën 97,200 lekë me tvsh për L. M PF. Proces Verbali i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 14.07.2022.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike për artikullin materiale të shtypura mbi rreziqet natyrore, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 14.07.2022 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas



të gjitha specifitimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

4. Me shkresë nr. 243, datë 07.04.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Të tjera materiale dhe shërbime – Web Hosting”, me urdhër prokurimi nr. 04, datë 07.04.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 07.04.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 49,992 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 45/2022, datë 12.04.2022, likujduar në vlerën 57,600 lekë me tvsh për I sh.p.k. Proces Verballi i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 12.04.2022. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifitime teknike apo parametra për shërbimin, si dhe nuk pasqyrohet një grafik lëvrimi nëse mirëmbajtja do të bëhet në periudha të ndryshme. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifitimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit citohet se fondi është llogaritur nëpërmjet testimit të tregut pasi shërbimi i kërkuar nuk është gjendje në magazinë, ndërkohë që në kërkesën e bërë për këtë prokurim citohet se periudha e mirëmbajtjes së faqes ëeb përfundon në muajin prill. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Pra në tërësi procedura është zhvilluar tepër formale dhe pa detajime mbi objektin konkret të prokurimit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
5. Me shkresë nr. 560, datë 26.08.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Furnizime dhe materiale zyre dhe të përgjithshme”, me urdhër prokurimi nr. 16, datë 26.08.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 26.08.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 83,299 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 462/2022, datë 24.10.2022, likujduar në vlerën 98,760 lekë me tvsh për TIM sh.p.k. Proces Verballi i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 24.10.2022. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifitime teknike apo parametra për pajisjet e llojit IT, si dhe nuk pasqyrohet një grafik lëvrimi i mallrave. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifitimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Pra në tërësi procedura është zhvilluar tepër formale dhe pa detajime mbi objektin konkret të prokurimit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
6. Me shkresë nr. 197, datë 16.03.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “kancelari e të tjera”, me urdhër prokurimi nr. 01, datë 16.03.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 16.03.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 177,657 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 116/2022, datë 23.03.2022, me vlerë 202,920 lekë me tvsh për T.sh.p.k.
7. Me shkresë nr. 899, datë 06.02.2022 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Materiale për funksionimin e zyrave – bojë shkrimi”, me urdhër prokurimi nr. 22, datë 06.12.2022, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 06.12.2022, referuar çmimeve të tregut, me fond limit

325,068 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 209/2022, datë 14.12.2022, me vlerë 329,280 lekë me tvsh. Nga auditimi rezulton se më datë 09.12.2022 është mbajtur procesverbali sipas të cilit operatori i shpallur fitues tërhiqet nga përmbushja e objektit të prokurimit dhe vijohet procedura me operatorin e dytë fitues. Me procesverbal datë 14.12.2022 është bërë marrja në dorëzim e mallrave në kundërshtim me afatin prej 2 ditë pune nga shpallja e fituesit të përcaktuar në ftesën për ofertë.

### **Për vitin 2023**

Është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nr. 68 Prot., datë 11.01.2023 me përbërje si vijon:

Z. A T – Kryetar

Zj. F Z – Anëtare

Zj. A H – Anëtare

Me urdhër nr. 69 prot., datë 11.01.2023 është krijuar komisioni për pritjen e mallit dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve për procedurat e blerjes me vlerë të vogël për vitin 2023 me përbërje:

Z. V G – Kryetar

Z. A.I – Anëtar

Z. E R – Anëtar

Zj. M O – Anëtare

1. Me shkresë nr. 339, datë 02.05.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Krijim dhe publikim i materialeve të shtypura”, me urdhër prokurimi nr. 07, datë 02.05.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 02.05.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 99,333 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 255/2023, datë 04.05.2023, me vlerë 115,800 lekë me tvsh. Proces Verbal i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 04.05.2023.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike për artikullin materiale të shtypura mbi rreziqet natyrore, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 04.05.2023 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifikimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Me shkresë nr. 798, datë 11.12.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik”, me urdhër prokurimi nr. 32, datë 11.12.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 11.12.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 83,010 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 684/2023, datë 18.12.2023 me vlerë 96,720 lekë me tvsh. Proces Verbal i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 18.12.2023. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike kryesisht për mallrat të llojit kartolina, apo stilo e personalizuar, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 18.12.2023 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifikimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po

kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Me shkresë nr. 737, datë 10.11.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Shërbime printimi dhe publikimi – fletëpalosje dhe brodhura informuese”, me urdhër prokurimi nr. 21, datë 10.11.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 10.11.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 83,000 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 598/2023, datë 14.11.2023 me vlerë 97,200 lekë me tvsh. Proces Verballi i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 14.11.2023. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike për artikujt fletëpalosje informuese për përmbajtjet dhe zjarret, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 14.11.2023 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifikimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
4. Me shkresë nr. 868, datë 28.12.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Blerje dokumentacioni”, me urdhër prokurimi nr. 35, datë 28.12.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 28.12.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 83,240 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 728/2023, datë 28.12.2023 me vlerë 98,400 lekë me tvsh. Proces Verballi i dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve me datë 28.12.2023. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike kryesisht për mallrat të llojit kartolina, apo stilo e personalizuar, për të cilat është e paqartë se në cilin format nevojiten, me çfarë përmbajtje, etj. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim më datë 28.12.2023 citohet se komisioni konfirmon përputhshmërinë me sasinë, cilësonë, llojin, plotësinë dhe markën sipas të gjitha specifikimeve, ndërkohë që këto elementë nuk dokumentohet të jenë përcaktuar. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
5. Me shkresë nr. 390, datë 30.05.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Kancelari”, me urdhër prokurimi nr. 11, datë 30.05.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 30.05.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 99,844 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 213/2023, datë 06.06.2023, me vlerë 118,780 lekë me tvsh. Nga dokumentacioni në dispozicion nuk dokumentohet shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave.
6. Me shkresë nr. 747, datë 16.11.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje të ambienteve higjieno-sanitare”, me urdhër prokurimi nr. 24, datë 16.11.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 16.11.2023, referuar çmimeve të manualit teknik miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, i ndryshuar me fond limit 92,653 lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk është argumentuar nevoja për këtë shpenzim, nuk evidentohet ndonjë procesverbal i mbajtur për dëmtimet apo nevojën për riparime në ambientet higjieno-

sanitare dhe as mallrat apo shërbimet që nevojiten. Nga auditimi konstatohet se pavarësisht procedurës së thjeshtuar shkresore në vlera nën 100,000 lekë, për llojin e punimeve që do të kryhen nuk është përcaktuar asnjë kriter kualifikimi minimalisht për paraqitjen e suksesshme të punëve të ngjashme nga operatori i përzgjedhur. Po kështu, nuk evidentohet as shpallja e fituesit nga titullari, apo data dhe vendi i përmbushjes së objektit të prokurimit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 dhe nenin 25 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. Me shkresë nr. 807, datë 11.12.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje të objekteve ndërtimore – godina e nën prefektit Pukë”, me urdhër prokurimi nr. 33, datë 11.12.2023, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 11.12.2023, referuar çmimeve të manualit teknik miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, i ndryshuar, me fond limit 833,231 lekë dhe fituar nga operatori ekonomik HB-G me vlerë oferte 784,000 lekë. Nga auditimi konstatohet se kërkesa nuk shoqërohet me argumentimin përkatës të nevojës për këtë shpenzim, nuk evidentohet ndonjë procesverbal i mbajtur për dëmtimet apo nevojën për riparime në godinë, ndërkohë që projekt preventivi i punimeve nuk është hartuar nga një specialist i fushës por nga vetë nën prefekti z. Gj Gj. Nga auditimi konstatohet gjithashtu se nuk është përcaktuar asnjë kriter kualifikimi, minimalisht për paraqitjen e suksesshme të punëve të ngjashme nga operatori ofertues, apo kriteret e tjera të detyrueshme sipas kuadrit ligjor. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2 dhe 25 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për sa trajtuar më lart, në mënyrë të përmbledhur rezulton se për periudhën objekt auditimi, Prefektura Shkodër ka realizuar vetëm procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël ose nën vlerën 100,000 lekë, për të cilat konstatohet se dokumentimi bëhet në mënyrë tepër formale pa përcaktuar kriteret kualifikimi dhe specifikime teknike, pa shpallje fituesi dhe përcaktimi të vendit dhe datës së kryerjes së dorëzimit të mallrave e shërbimeve, apo pa u shoqëruar me argumentimin e detajuar të nevojës për shpenzime. Po kështu konstatohet se ndër rastet e trajtuara ka copëzim të fondit për blerje të të njëjtës natyrë, kryesisht ato me vlerë nën 100,000 lekë për të cilat është shmangur realizimi i procedurës përkatëse me mjete elektronike, të tilla si shtypshkime, fletëpalosje, broshura etj, apo kancelari dhe bojë printimi. Konkretisht në 4 raste gjatë vitit 2022 dhe në 3 raste gjatë vitit 2023 për shpenzime me objekt printime fletëpalosje, broshura, kartilina, etj, në 2 raste gjatë vitit 2022 për pajisje apo shërbime IT, në 3 raste gjatë vitit 2022 për blerje kancelari, bojëra printimi etj, si dhe në 2 raste gjatë vitit 2023 për punime apo mirëmbajtje godine. Vihet re se ky lloj shpenzimi kryhet masivisht dhe nuk janë shpenzime që lindin nga raste emergjence apo të paparashikuara, por janë procedura të parashikuara që në regjistrin e parashikimeve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikat b, c dhe 3 të nenit 2, pikën 1/c dhe 5 të nenit 11, pikën 3 të nenit 12 dhe nenin 25 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi znj. M.A, z. A.T, znj. F.Z dhe znj. A.H*

### 3. AUDITIM MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTEVE NORMATIVE, URDRHAVE E URDHËRESAVE ME KARAKTER NORMATIV TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit nr. 566/1, datë 31.05.2024, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u auditua dokumentacioni i mbajtur për ligjshmërinë e akteve normative të miratuara nga organet e njëjësive të qeverisjes vendore si projekt vendimet e Këshillave Bashkiak, Vendimet e tyre, relacionet shoqëruese, korrespondencat përkatëse në rastet e kthimit dhe mos miratimit të VKB, etj.

#### Viti 2022

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se **për vitin 2022** pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, nga 6 njësi të qeverisjes vendore (5 bashki dhe Këshilli i Qarkut Shkodër), janë depozituar gjithsej 295 akte normative, nga të cilat për 274 akte normative është konkluduar në përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore dhe është vijuar me miratimin e tyre, ndërkohë për 21 akte nuk është lejuar procedim i mëtejshëm. Nga auditimi rezulton se refuzimet dhe mos lejimi i procedimit janë argumentuar saktë dhe të mbështetura në bazë ligjore. Në formë tabelare treguesit për vitin 2022 paraqiten si vijon:

Nr.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve te organeve te njëjësive të vetëqeverisjes vendore						Verifikimi në vend i ligjshmërisë	Derguar ne gjykatë
	NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE	Akte të hyra në Institucionin e		Të bazuara ne ligj	Të refuzuara	Të rishqyrtuar nga OQV		
		Gjithsej	Nga të cilat: Akte Normative					
<b>A</b>	<b>Këshilli i Qarkut</b>	12	12	12	0	0	1	0
<b>B</b>	<b>Bashkite</b>							
<b>1</b>	<b>Bashkia Shkodër</b>	61	61	58	3	0	3	0
<b>2</b>	<b>Bashkia Vau Dejës</b>	77	77	69	8	0	2	0
<b>3</b>	<b>Bashkia Puke</b>	42	42	40	2	0	2	0
<b>4</b>	<b>Bashkia Fushë Arrëz</b>	41	41	37	4	1	2	0
<b>5</b>	<b>Bashkia Malesi e Madhe</b>	62	62	58	4	0	2	0
<b>Shuma B</b>		<b>283</b>	<b>283</b>	<b>262</b>	<b>21</b>	<b>1</b>	<b>11</b>	<b>0</b>
<b>Total Qarku (A+B)</b>		<b>295</b>	<b>295</b>	<b>274</b>	<b>21</b>	<b>1</b>	<b>12</b>	<b>0</b>

Në mënyrë të përmblodhur rezulton se vendimmarrjet shqyrtuar gjatë vitit 2022 kanë të bëjnë me

- planifikimin e buxheteve vendore të cilat paraqesin detyrim analizimin e elementeve buxhetore;
- vendime të miratuara nga organi kolegjal me objekt rishpërndarjen e fondeve buxhetore, për të cilat është kërkuar respektimi i qartë i qëllimit dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor, respektimit rigoroz të destinacionit të transfertave specifike, veçanërisht në përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave,;

- vendime lidhur me fondin e kushtëzuar në zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- vendime mbi sistemin fiskal të bashkive si burimi buxhetor i rëndësishëm për bashkitë nëse përdoren me efektivitet nga vetë bashkitë mënyrat e vjeljes;
- praktikat e miratuara për dhënie në përdorim të pronës publike, kryesisht të dhënieve të fondit pyjor/kullor me qera, për ndërtime HEC-esh;
- vendime për ndryshime në nivelin e pagave, etj.

Referuar edhe tabelës më lart, rezulton se gjatë vitit **2022**, prefekti i Qarkut Shkodër ka refuzuar miratimin e VKB në 21 raste ose 7.1% e VKB dhe konkretisht:

- 3 raste të Bashkisë Shkodër për tejkalim të afateve parashikuar nga neni 34, pika 4 e Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”; për ndryshim destinacioni për përdorimin e fondeve akorduar për qëllime ndihme ndaj shtetasve dhe banesave të dëmtuara dhe jo ndërhyrje emergjente në objekte publike të dëmtuara, si dhe pasaktësi në plotësimin e tabelave dhe kategorive të pagave për ndryshime në nivelin e pagave.
- 8 raste të Bashkisë Vau i Dejës për mos citimin e saktë të bazës ligjore dhe mungesë të relacionit argumentues bashkëlidhur; për kërkesë për shpërblimin e stafit të MZSh pa miratuar në buxhet fondin e veçantë prej 5%, për mungesë të dokumentacionit pronësor dhe paqartësi në kategorizimin e llojit të pronës që propozohet për dhënie me qera; për dhënien për ndërtim të sistemeve fotovoltaike në kundërshtim me llojin e zhvillimit të sipërfaqes në fjalë, si dhe pa saktësi në rishpërndarjen në disa zëra të buxhetit
- 2 raste të Bashkisë Pukë për mos analizim të efekteve në buxhet, mos zhvillimin e seancave të konsultimit dhe mos përcaktimin e qartë të taksave dhe tarifave vendore që propozohen tju përjashtohen subjekteve me mbi 10 punonjës, si dhe për ndryshim destinacioni për përdorimin e fondeve akorduar për qëllime ndihme ndaj shtetasve dhe banesave të dëmtuara dhe jo ndërhyrje emergjente në objekte publike të dëmtuara.
- 4 raste të Bashkisë Malësi e Madhe për mos dorëzim të statusit juridik dhe mos citimin e bazës së duhur ligjore për ndryshimin e fushës së përdorimit të pasurisë; për tejkalimin e vlerës së ndihmës financiare në kundërshtim me parashikimet ligjore; për mos argumentim dhe mos realizim të konsultimit publik për ndryshimet në paketën fiskale, si dhe dhënien me qera të ngastrave të cilat nuk janë pjesë e fondit pyjor të transferuar me VKM.
- 4 raste të Bashkisë Fushë Arrëz për përdorimin e zërit jo të duhur të fondeve për pastrimin e qytetit nga dëmet e përmytjeve; për mos hartimin e planit të masave ndaj zjarreve sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, si dhe mos analizimi dhe përcaktimi i efekteve financiare për përbalimin e shtimit të numrit të punonjësve.

### **Verifikimet në vend**

Krahas verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative të dërguara nga Bashkitë, referuar nenit 17 të Ligjit 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ edhe drejtpërdrejt në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më pak se një herë në 3 muaj, pra jo më pak se 4 herë në vit. Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022 Prefektura Shkodër ka realizuar procesin e verifikimit të ligjshmërisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore konkretisht **vetëm 1 herë/vit në Këshillin e Qarkut, 3 herë/vit në Bashkinë Shkodër dhe vetëm 2 herë/vit në Bashkitë Fushë Arrëz, Vau i Dejës, Pukë dhe Malësi e Madhe, duke rritur riskun e mos garantimit nëse këto njësi vendore i kanë depozituar të gjitha aktet normative pranë Prefektit**. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura gjatë verifikimeve në vend, konstatohet se vazhdimisht grupi i verifikimit ka tërhequr vëmendjen në raportimet e tyre

mbi mungesën e konsultimeve publike gjatë vendimmarrjeve të këshillit, e megjithatë në pjesën më të madhe të konfirmimeve, aktet normative që nuk shoqërohen me dokumentacionin mbi konsultimin publik nuk janë kthyer.

### **Viti 2023**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se **për vitin 2023** pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, nga 6 njësi të qeverisjes vendore (5 bashki dhe Këshilli i Qarkut Shkodër), janë depozituar gjithsej 346 akte normative, nga të cilat për 321 akte normative është konkluduar në përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore dhe është vijuar me miratimin e tyre, ndërkohë për 25 akte nuk është lejuar procedim i mëtejshëm. Nga auditimi rezulton se refuzimet dhe mos lejimi i procedimit janë argumentuar saktë dhe të mbështetura në bazë ligjore. Në formë tabelare treguesit për vitin 2023 paraqiten si vijon:

Nr.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve te organeve te njësive të vetëqeverisjes vendore					Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve	Derguar ne gjykate	
	NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE	Akte të hyra në Institucionin e		Të bazuara ne ligj	Të refuzuara			Të rishqyrtuara nga OQV
		Gjithsej	Nga të cilat: Akte Normative					
A	Këshilli i Qarkut	25	25	25	0	0	1	0
B	Bashkite							
1	Bashkia Shkodër	79	79	76	3	0	2	0
2	Bashkia Vau Dejës	89	89	75	14	2	1	0
3	Bashkia Puke	55	55	50	5	0	2	0
4	Bashkia Fushë Arrëz	44	44	41	3	0	2	0
5	Bashkia Malesi e Madhe	54	54	54	0	0	1	0
<b>Shuma B</b>		<b>321</b>	<b>321</b>	<b>296</b>	<b>25</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>0</b>
<b>Total Qarku (A+B)</b>		<b>346</b>	<b>346</b>	<b>321</b>	<b>25</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>0</b>

Në mënyrë të përmbledhur rezulton se vendimmarrjet shqyrtuar gjatë vitit 2023 kanë të bëjnë me

- planifikimin e buxheteve vendore të cilat paraqesin detyrim analizimin e elementeve buxhetore;
- vendime të miratuara nga organi kolegjal me objekt rishpërndarjen e fondeve buxhetore, për të cilat është kërkuar respektimi i qartë i qëllimit dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor, respektimit rigoroz të destinacionit të transfertave specifike, veçanërisht në përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave,;
- vendime lidhur me fondin e kushtëzuar në zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- vendime mbi sistemin fiskal të bashkive si burimi buxhetor i rëndësishëm për bashkitë nëse përdoren me efektivitet nga vetë bashkitë mënyrat e vjeljes;
- praktikat e miratuara për dhënie në përdorim të pronës publike, kryesisht të dhënieve të fondit pyjor/kullor me qera, për ndërtime HEC-esh;
- vendime për ndryshime në nivelin e pagave, etj.

Referuar edhe tabelës më lart, rezulton se gjatë vitit **2023**, prefekti i Qarkut Shkodër ka refuzuar miratimin e VKB në 25 raste ose 7.2% e VKB dhe konkretisht:

- 3 raste të Bashkisë Shkodër për mangësi në dokumentacionin e paraqitur gjatë aplikimit nga subjekti privat për marrjen në përdorim të fondit pyjor; për propozim të ndryshimit të destinacionit të përdorimit në kundërshtim me VKM dhe në mungesë të statusit juridik, si dhe një rast për mos përfshirje të propozimit në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti ka detyrimin të shprehet.
- 14 raste të Bashkisë Vau i Dejës për mos depozitim të certifikatës së pronësisë dhe statusit juridik të pronës për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor; për mos paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga subjekti privat për marrjen me qera me anë të konkurimit; për dhënie në përdorim të sipërfaqes së llojit Arë apo Kullotë e cila referuar korrespondencës me AShK, nuk është në pronësi të Bashkisë; për dhënien e ndihmës financiare për dëme në banesë, në kundërshtim me udhëzimet e Entit të Banesave, si dhe për mos argumentim të vendimit.
- 5 raste të Bashkisë Pukë për referim të pa saktë të bazës ligjore, mungesë të dokumentacionit shoqërues dhe mungesë të certifikatës së pronësisë në propozimin për hapje rruge; paqartësi në vendim për dhënie në përdorim apo heqje nga fondi pyjor dhe vendosje e gabuar e tarifave në kundërshtim me VKM përkatëse; mungesë dokumentacioni shoqërues për dhënie mandate.
- 3 raste të Bashkisë Fushë Arrëz për kryerje të investimeve të pa planifikuara gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në kundërshtim me Kodin zgjedhor; mos përfshirje të vendimit në rendin e ditës, si dhe pasaktësi në përbërjen e Komisioneve këshillimore për dhënien e titujve të nderit.

### **Verifikimet në vend**

Sa i takon verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ edhe drejtpërdrejt në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më pak se 4 herë në vit, nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 Prefektura Shkodër ka realizuar procesin e verifikimit të ligjshmërisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore konkretisht vetëm 1 herë/vit në Këshillin e Qarkut dhe Bashkitë Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe dhe vetëm 2 herë/vit në Bashkitë Shkodër, Fushë Arrëz dhe Pukë, duke rritur riskun e mos garantimit nëse këto njësi vendore i kanë depozituar të gjitha aktet normative pranë Prefektit, në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”.

### **Proceset Gjyqësore**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 “Për Prefektin”, ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është pjesë e proceseve gjyqësore, kryesisht si palë e tretë. Për periudhën objekt auditimi 2022-2023 nuk ka patur praktika të dërguara në Gjykatë. Megjithatë nga auditimi në tërësi i procedurave të ndjekura nga Prefekti i Qarkut për verifikimin e ligjshmërisë së akteve normative, duke ju referuar kuadrit ligjor në fuqi në nenin 16 të Ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, përcaktohet se *Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:*

- a) *çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijeni nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit;*
- b) *për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:*



- në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkëlqet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;
- vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike;
- në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti.

Nga auditimi rezultoi se nga 46 VKB të pa konfirmuara nga Prefekti i Qarkut për periudhën 2022-2023, vetëm në 3 raste janë rikthyer pranë Prefektit Vendimet e rishqyrtuara nga Bashkitë, ndërkohë që për 43 të tjera Prefekti i Qarkut nuk ka marrë masa për ndjekien e mëtejshme të tyre dhe nuk konstatohet të jetë shprehur për këto Vendime as gjatë procesit të verifikimit në vend sipas pikës 2 të nenit 17 të Ligjit të sipërcituar, “Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti i qarkut konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, kërkon pavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative”. Në vijim të trajtimit sa më lart, konstatohet se nuk ka patur asnjë reagim nga Prefekti për aktet normative të kthyera për rishqyrtim. Referuar përcaktimeve të pikës 2 të nenit 17 cituar më lart, Prefekti ka kompetencën që nëse gjatë verifikimit në vend të akteve normative, konstaton vendime të pa depozituara tek ai sipas përcaktimeve të nenit 16, kërkon pavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Në këtë kontekst, referuar edhe nenit 119 të Kodit të Procedurës Civile, “Akti procedural që nuk është kryer në formën që kërkohet shprehimisht nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm”, pra sipas këtij përcaktimi të gjithë vendimet e pa kthyera pranë Prefektit pas rishqyrtimit janë automatikisht të pa vlefshëm. Për sa më lart, për sa kohë Prefekti i qarkut është i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore, duhet të rritet kërkesa e llogarisë ndaj respektimit të procedurave të njëpasnjëshme sipas përcaktimeve të nenit 16, pika b, si dhe të dokumentojë se si është vijuar për ato akte të cilat nuk janë kthyer tek Prefekti pas rishqyrtimit.

### **Verifikimi i Ligjshmërisë për Aktet Normative të konfirmuara**

Nga auditimi me përzgjedhje i akteve normative të verifikuara dhe miratuara nga Prefekti i Qarkut rezultuan me mangësi si vijon:

#### **Bashkia Vau i Dejës**

1. Me shkresë nr. 103/1, datë 10.02.2022, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për **VKB nr. 04, datë 26.01.2022, “Për miratimin e vazhdimin të procedurës për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës, të pasurisë nr. 371, ZK3506 e llojit Pa fryt në fshatin Stajkë”**. Nga auditimi rezulton se dokumentacioni i dorëzuar pranë Prefektit përmban Projekt vendimin dhe Vendimin e KB, Procesverbalet e mbledhjes së Këshillit të cilët rezultojnë të pa rregullt pasi nuk korrespondon numri i votave të cilët kanë miratuar vendimet me numrin e nënshkrimeve dhe listëprezencën e këshilltarëve, si dhe relacioni dërguar Këshillit Bashkiak i pa protokolluar, në të cilin citohet se prona kërkohet për transferim për qëllim zhvillimi ekonomik, duke mos argumentuar as llojin e transferimit që kërkohet, as formën e

përdorimit shoqëruar edhe me një plan zhvillimi apo plan biznesi se çfarë është planifikuar të realizohet, veprime në kundërshtim me nenet 3 dhe 5 të Ligjit nr. 8744, datë 22.01.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe pa cituar numrin rendor të pronës në listën e inventarit, në kundërshtim me pikën 1a, të Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”. Në vijim, dokumentacioni i dërguar prefektit përmban kartelën e pasurisë për pronën në fjalë e cila rezulton shtet e llojit e pa frytshme, por nuk është shoqëruar me statusin juridik nga ASHK, në mungesë të certifikatës së pronësisë, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Aneksit 1 pjesë e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut. Krahas sa më lart, konstatohet se për propozimin për transferimin e pronësisë nuk dokumentohet të jenë respektuar procedurat e parashikuara nga nenet 35 dhe 37 të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilëve veprimet me pronat shtetërore fillojnë pas përditësimit të plotë të informacionit mbi gjendjen faktike, si dhe mbi të drejtat apo detyrimet që rëndojnë mbi to dhe për këtë proces, Bashkia duhet të administrojë dhe dokumentojë pranë Prefektit a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj.

2. Me shkresë nr. 106/1, datë 04.02.2022, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për **VKB nr. 7, datë 26.01.2022, “Për antenë radiofonike dhe televizive në ekonominë pyjore Bushat Bërdicë, ngastra 14/a me sipërfaqe 0.0205 ha”**. Nga auditimi rezulton se dokumentacioni i dërguar për procedurën e mësipërme nuk shoqërohet me procesverbal të rregullt të mbledhjes, pasi nuk korrespondon numri i votave të cilët kanë miratuar vendimet me numrin e nënshkrimeve dhe listëprezencën e këshilltarëve, mungon statusin juridik i pronës dhe nuk disponohet as ndonjë dokumentacion tjetër hipotekor, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Aneksit 1 pjesë e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut, si dhe në mungesë të konsultimit publik në kundërshtim me Ligjin nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 17 dhe pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.
3. Me shkresë nr. 625/1 datë 07.10.2022, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për **VKB nr. 54, datë 23.09.2022, “Për dhënie ndihmë financiare familjes së z. J.C që i është dëmtuar banesa si pasojë e rënies së zjarrit”**. Nga auditimi rezulton se për vlerësimin e dëmeve, komisioni i ngritur nga Titullari i Bashkisë ka përllogaritur dëmet në orendi, pajisje dhe elektroshtëpiake referuar shkresës nr. 373/1, datë 17.05.2016 të Prefekturës Shkodër, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndërkohë që për vlerësimin e dëmeve të objektit ndërtimor, me relacionin pa protokoll dhe datë të një prej anëtareve të komisionit është konkluduar se banesa me sipërfaqe totale prej 32 m<sup>2</sup> është e shkatërruar plotësisht dhe për këtë qëllim është proceduar me përcaktimin e koston mesatare të ndërtimit nga fillimi prej 32,624 lekë/m<sup>2</sup> sipas përcaktimeve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose të tjera shkaktuar nga veprimtaria njerëzore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në

dispozicion, rezulton se i dëmtuari ka dorëzuar çertifikatën e pronësisë, ku vihet re se disponon pasurinë me sipërfaqe trualli 200m<sup>2</sup> nga të cilat 174 m<sup>2</sup> ndërtesa, nga ku konstatohet mos përputhje me relacionin e hartuar nga anëtarja e komisionit të vlerësimit të dëmeve e cila pohon se ndërtesa ka sipërfaqe totale prej 32 m<sup>2</sup> dhe duhet të ndërtohet nga fillimi dhe në rast të dëmtimit vetëm të kësaj sipërfaqeje, nuk duhet të kryhej vlerësimi sipas kostos mesatare të ndërtimit nga fillimi, por sipas çmimeve në fuqi sipas zërave të ndërtimit. Për sa më lart VKB duhet të kthehet për saktësim nëse ndërtesa është dëmtuar e gjitha apo vetëm sipërfaqja prej 32m<sup>2</sup>. Po kështu, konstatohet se procesverbalet e mbledhjes së Këshillit rezultojnë të pa rregullt pasi nuk korrespondon numri i votave të cilët kanë miratuar vendimet me numrin e nënshkrimeve dhe listëprezencën e këshilltarëve në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Rregullores së brendshme të funksionimit miratuar me Urdhër nt. 175, datë 09.07.2020 të Ministrit të brendshëm.

### **Bashkia Pukë**

1. Me shkresë nr. 319/1, datë 20.05.2022, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për ***VKB nr. 16, datë 05.05.2022, “Mbi dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqie nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqes prej 0.02 ha në ekonominë pyjore Gomsiqë, për ndërtimin e impjantit gjenerues elektrike eolike 2 MË nga shoqëria D 2020”***. Nga auditimi rezulton se ligjshmëria është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit teknik për sipërfaqet, si plan vendosje, kartelë apo status juridik i pronës, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Rregullores së brendshme të funksionimit miratuar me Urdhër nr. 175, datë 09.07.2020 të Ministrit të brendshëm, si dhe në mungesë të konsultimit publik në kundërshtim me Ligjin nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 17 dhe pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.
2. Me shkresë nr. 168/1, datë 24.02.2023, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për ***VKB nr. 3, datë 06.02.2023, “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqies nga fondi pyjor/kullosor publik për 0.016 ha për ndërtimin e impjantit gjenerues të energjisë elektrike eolike 2 MË, nga shoqëria V. sh.p.k, ngastra 15/a në ekonominë pyjore Gomsiqe”***. Nga auditimi rezulton se ligjshmëria është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit teknik për sipërfaqet, si plan vendosje, kartelë apo status juridik i pronës, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Rregullores së brendshme të funksionimit miratuar me Urdhër nt. 175, datë 09.07.2020 të Ministrit të brendshëm, si dhe në mungesë të konsultimit publik në kundërshtim me Ligjin nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 17 dhe pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.
3. Me shkresë nr. 248/1, datë 30.03.2023, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për ***VKB nr. 6, datë 13.03.2023, “Mbi miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari për vitin 2023***. Nga auditimi rezulton se ligjshmëria është konfirmuar të dokumentacionit teknik për sipërfaqet, si plan vendosje, kartelë apo status juridik i pronës, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Rregullores së brendshme të funksionimit miratuar me Urdhër nt. 175, datë 09.07.2020 të Ministrit të brendshëm, si dhe në mungesë të konsultimit publik në kundërshtim me Ligjin nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 17 dhe pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

## **Bashkia Malësi e Madhe**

Nga auditimi rezulton se në disa raste janë konfirmuar Vendime të Këshillit Bashkiak në lidhje me miratimin për dhënie me qira të parcelave pyjore-kullosore, me mangësi të procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak, dokumentit nga ASHK për statusin e pronës, planvendosjes dhe dokumentit të dëgjësave publike, të cilat duhet të ishin kthyer për rishikim ose plotësim, duke qenë se bien në kundërshtim të rregullores të miratuar me urdhrin e Mnistrisë të Brendshme nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti I Qarkut”, Kreu i II “Procedura e verifikimit të ligjshmërisë së akteve ligjore të njësisë të vetëqeverisjes vendore” neni 4 “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” pika 1/b në të cilën përcaktohet se: *“Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:*

*i. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit;*

*ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;*

*iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;*

Dokumentacioni që duhet të paraqitet si shoqërues i projektvendimit, relacionit dhe raportit tekniko-ligjor janë:

-Leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë

-Planvendosja e objektit

-leja e mjedisit

-leja e ndertimit

-akti i regjistrimit pranë QKR-ës

*iv. Projektvendim;*

*v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendim-marrjen e pronave), planvendosjet;*

*vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendim-marrjes me karakter financiar);*

*vii. Dokumentacionin përkatës sipas standartit të kërkuar (në rastin e vendim-marrjes për emergjencat civile). ”*

- ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet” i ndryshuar, neni 17 “Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet”, pika 1/f në të cilën përcaktohet se: *‘f) 1. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ka këto detyra: f. bashkëpunon me shoqërinë civile dhe organizatat e ngritura mbi baza ligjore me objekt të tyre “pyllin”, si dhe garanton gjithëpërfshirjen e popullsisë lokale për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor që ka në pronësi.”*

- ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, **Neni 18** “Seancat e këshillimeve me bashkësinë” përcaktohet se: *‘Pika 1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji. Neni 54 “Kompetencat e Këshillit Bashkiak”, nënpika (e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”. Rastet e konfirmimit të VKB-ve të tilla janë si më poshtë:*

1. Shkresa nr.prot.522/1 datë 11.08.2022 “Mbi vendimin nr.29 datë 29.07.2022 të KB të Malësisë së Madhe “Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes pyjore 14.874 ha për ndërtimin e HEC-ve Kozhnje 1 dhe Kozhnje 2 Tamarë nga Shoqëria “T”shpk dhe heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes 0.88 ha, që bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosore “Vukel-Nikç”.

Dokumentacioni përmban: Kontratën e koncesionit, harta e vendosjes së parcelave, njoftimi dhe protokollit i mbledhjes së KB datë 29.07.2022, ku për çështjen e parë, objekt i VKB theksohet se : *“Kryetari i Këshillit hedh në votim dhe të gjithë janë pro 21 vota pro, ndërkohë që në fund të protokollit të mbledhjes kanë firmosur vetëm Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit. Në këtë protokoll nuk evidentohet prezenca e këshilltarëve pjesmarrës dhe nënshkrimi i tyre. Për sa më lart vendimi duhej të ishte kthyer për parregullsi.*

2. Shkresa nr.prot.305/1, datë 18.05.2022 “Mbi vendimin nr.16, datë 26.04.2022 të KB të Malësisë së Madhe ‘Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes pyjore për ndërtimin e linjës së ujit për objektin ‘Fabrikë për ambalazhimin në shishe ose enë dhe prodhimin e lengjeve nga shoqëria C. shpk dhe heqjen nga fondi pyjor i sipërfaqes që përshkohet nga linjat e dërgimit të ujit tek linja e prodhimit të subjektit mbi lumin e Cemit Tamarë NJA Kelmend”.

3. Shkresa nr.prot.304/1, datë 18.05.2022 “Mbi vendimin nr.15, datë 26.04.2022 të KB të Malësisë së Madhe ‘Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes pyjore kullimore në NJA Shkrel me afat 10 vjeçar të një sipërfaqe pyjore prej 0.5783 ha, që shtrihet në ngastrën 101/a pjesë e ekonomisë pyjore ‘Fusha e zezë‘, për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje“. (ka planvendosje). Për këto dy VKB janë dërguar: hartat e vendosjes së parcelave, protokollit i mbledhjes së KB datë 26.04.2022, ku për çështjet katër dhe pesë, objekt të VKB-ve theksohet se : *“Kryetari i Këshillit hedh në votim dhe të gjithë janë pro 22 vota pro...., ndërkohë që në fund të protokollit të mbledhjes kanë firmosur vetëm Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit. Në këtë protokoll nuk evidentohet prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në mbledhje dhe nënshkrimi i tyre.*

Po kështu, në disa raste të konfirmimit të VKB në lidhje me dhënien e ndihmave financiare në raste fatkeqësish nga dëmtimet e shtëpive të individëve nga zjarri, konstatohet se nuk është theksuar vlera përfundimtare e dëmshpërblimit që do të financohet, mangësi që duhet të përbënte objekt për rishikim dhe plotësim të VKB-ve para konfirmimit nga Prefektura pasi sipas ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “për mbrojtjen civile”, neni 41 dhe me VKM nr.329, datë 16.05.2012 ‘Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, ku në Kreun III, pikën 3/ç përcaktohet se:

*ç) Masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Brendshme ose njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin "Emergjencat civile". Ajo do të llogaritet në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në shkronjat "b" dhe "c" të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës së llogaritur.*

Për këto raste është proceduar me përlllogaritjen e dëmeve, por në VKB nuk përcaktohet shprehimisht vlera konkrete e dëmshpërblimit.

Rastet e konfirmimit të VKB-ve të tilla janë si më poshtë:

1. Shkresa nr.prot.429/1 date 05.07.2022 “Mbi vendimin nr.28, datë 27.06.2022 të KB të Malësisë së Madhe ‘Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të z. P. L. V., fshati Vrakë, NJA Gruemirë, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, (sipas vërtetimit të MZSH për rënie zjarri nr.1481/1prot.të datës 19.05.2022) si dhe për akordimin e ndihmës financiare nga programi ,‘Mbrojtja nga Zjarri dhe mbrojtja civile“, e këtij shtetasi nga programi 3280 i buxhetit ‘Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile“ miratuar me VKB nr.70, datë 29.12.2022.” Në këtë vendim është miratuar dhënia e një

ndihme të menjëhershme prej 100,000 lekë, miratimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në vlerën e dëmit për paisjet elektroshtëpiake në vlerën 283,900 lekë dhe vlerën e dëmit nga ana ndërtimeve prej 2,353,415 lekë (shoqëruar me preventiv të hartuar nga Bashkia). Për këtë VKB është dërguar: protokollin e mbledhjes së KB datë 20.06.2022, ku për çështjen njëmbëdhjetë, objekt i VKB theksohet se :“*Kryetari i Këshillit hedh në votim dhe të gjithë janë pro 26 vota pro*. Në fund të protokollit të mbledhjes kanë firmosur vetëm Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit, por nuk evidentohet prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në mbledhje si dhe nënshkrimi i tyre.

2. Shkresa nr.prot.306/1, datë 18.05.2022 “Mbi vendimin nr.17, datë 26.04.2022 të KB të Malësisë së Madhe “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të z. S.H, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, (sipas vërtetimit të MZSH për rënie zjarri nr.852 prot.të datës 18.03.2022), si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetasi nga programi 3280 i buxhetit ‘Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile‘ miratuar me VKB nr.70 datë 29.12.2022.” Në këtë vendim është miratuar dhënia e një ndihme të menjëhershme prej 100,000 lekë, miratimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në vlerën e dëmit për paisjet elektroshtëpiake në vlerën 245,400 lekë. Për këtë VKB është dërguar: protokollin e mbledhjes së KB datë 26.04.2022, ku për çështjen gjashtë, objekt i VKB theksohet se: “*Kryetari i Këshillit hedh në votim dhe të gjithë janë pro 22 vota pro*. Në fund të protokollit të mbledhjes kanë firmosur vetëm Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit, por nuk evidentohet prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në mbledhje dhe nënshkrimi i tyre.

3. Shkresa nr.prot.779/1, datë 18.05.2022 “Mbi vendimin nr.49, datë 31.10.2022 të KB të Malësisë së Madhe “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të z. L.H, fshati Brise, NJA Gruemirë, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, (sipas vërtetimit të MZSH për rënie zjarri nr.2257/1 prot.të datës 10.08.2022), si dhe për akordimin e ndihmës financiare nga programi 3280 i buxhetit “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile“ miratuar me VKB nr.70 datë 29.12.2022.” Në këtë vendim është miratuar dhënia e një ndihme të menjëhershme prej 100,000 lekë, miratimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në vlerën e dëmit për paisjet elektroshtëpiake në vlerën 278,080 lekë. Për këtë VKB është dërguar: protokollin e mbledhjes së KB datë 26.10.2022, ku për çështjen gjashtë, objekt i VKB theksohet se: “*Kryetari i Këshillit hedh në votim dhe të gjithë janë pro 20 vota pro*. Në fund të protokollit të mbledhjes kanë firmosur vetëm Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit. Në këtë protokoll nuk evidentohet prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në mbledhje si dhe nënshkrimi i tyre.

### **Bashkia Fushë Arrëz**

Edhe për këtë Bashki konstatohet si më lart konfirmimi i Vendimeve në mungesë të dokumentit nga ASHK për statusin e pronës, planvendosjes, si dhe dokumentit të dëgjësive publike si vijon:

1. Shkresa nr.prot. 253/1, datë 18.05.2022 “Mbi vendimin nr.15, datë 11.04.2022 të KB Fushë-Arrëz Për miratimin e dhënien në përdorim nga fondi pyjor të një sipërfaqe pyjore prej 8.65512 ha në ekonominë pyjore “Dardhë-Qebik”, parcelat pyjore 70/b,71/b,75/b, ekonominë pyjore “Goskë” parcelat pyjore 86,87/a, ekonominë pyjore “Kryezi”, parcelat pyjore 89/b,92/a,93/a, 96/a, 97/a, 98/a, 100/b, 101, 102, 103, 104, 105, 106/a, 107/a, ekonominë pyjore Iballë-Mzi 1, parcela pyjore 35/a, ekonominë pyjore “Qafë-plakë- Qafë Shari, parcelat pyjore 11/c,12/b,12/c,18/a,19/a, 20/b, 23/a, 30/b, 31/a, 32/b, 35/a ekonominë pyjore “Sakat-Lak Hithi”, parcela pyjore 99/a, për aktivitet vendosje anemometri të matjes së shpëjtësisë së erës dhe rrugës ndihmëse, nga shoqëria

“KMV”shpk në zonat kadastrale nr.1628,nr.3261 dhe nr.1979 në NJA Iballë, Blerim dhe Bashkia Fushë Arrëz.

2. Shkresa nr.prot. 866/1, datë 05.12.2022 “Mbi vendimin nr.44, datë 30.11.2022 të KB Fushë-Arrëz ‘Për dhënien e dakordësisë për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të një sipërfaqe pyjore prej 10.2143 ha në ekonominë pyjore “Iballë-Mezil”, parcelat pyjore 38/a, në ekonominë pyjore “Qafë plakë- Qafë Shari“, parcelat pyjore 12/b,12/c,18/a,19/a,20/b, 31/a, 32/b, në ekonominë pyjore Kryezi parcelat pyjore 89/b,92/a,93/a,97/a,99/a, ekonominë pyjore “Dardhë-Qebenik“, parcelat pyjore 33/a,71/b,75/b, ekonominë pyjore “Sakt-Lak Hithi“ parcelat pyjore 99/a,127/a,128/a,130/a,136/a,142/a,142/b, për aktivitetet vendosjen e turbinave të erës, sipërfaqe ndihmëse dhe linjë elektrike nga shoqëria “KMV“shpk, në zonat kadastrale nr. 1628, nr.1976 dhe nr.3261 në NJA Iballë, Blerim dhe Qafë Mali të Bashkisë Fushë Arrëz“.

Po kështu konstatohet se është konfirmuar ligjshmëria me shkresë nr.prot.371/1, datë 08.06.2022 “Mbi vendimin nr.24, datë 27.05.2022 të KB Fushë Arrëz ‘Për dhënien e ndihmës së menjëhershme familjes së shtetasit S.S.D, fshati Blerim, NJA Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar dhe rrezikon të shëmbet nga rrëshqitja e dheut, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare, mbështetur në shkresën e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar nr.612/2 prot., datë 10.05.2022 “Dërgim studim gjeologo-inxhinierik”, nga buxheti i bashkisë sipas programit “Emergjencat Civile” me ndihmë të menjëhershme 50,000 lekë si dhe vlerë dëmi 2,385,781 lekë, nga fondi i emergjencave civile. Vendimi është në kundërshtim me ligjin nr. 45, datë 18.07.2019 “për mbrojtjen civile”, neni 41 dhe me VKM nr.329, datë 16.05.2012‘Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“ nuk parashikohet ndihmë e menjëhershme financiare, ku në Kreun III, pikën 3/ç ‘Përcaktimi i ndihmës financiare’përcaktohet se:

*ç) Masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Brendshme ose njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin "Emergjencat civile". Ajo do të llogaritet në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në shkronjat "b" dhe "c" të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës së llogaritur.*

Për këto raste është proceduar me përlllogaritjen e dëmeve, por në VKB nuk përcaktohet shprehimisht vlera konkrete e dëmshpërblimit.

### **Bashkia Shkodër**

1. Shkresa nr.prot. 955/1, datë 30.12.2022 shqyrtoi VKB nr.68, datë 21.12.2022 ‘Për miratimin e vlerësimit paraprak dhe masë e shpërblimit paraprak për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të palujtshme, prona private, që preken për efekt investimi publik të objektit ‘Rikonstruksion rruga 1 Qeshori, Bashkia Shkodër me vlerë totale 2,285,701 lekë me burim financimi programi i buxhetit 045520 Rrjeti rrugor rural. Kësaj praktike i mungon projekti i këtij investimi dhe leja e zhvillimit dhe nuk ka axhendë për mbledhje. Përlllogaritja e vlerës së shpronësimit është bërë në bazë të VKM nr.127 datë 23.03.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik“, të VKM nr.89,datë 03.02.2016 „,“Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

2. Shkresa nr. prot. 952/1, datë 30.12.2022 shqyrtoi VKB nr.69, datë 21.12.2022 “Për miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit/kullësor për antenat e telefonisë celulare, pronë e Bashkisë Shkodër, në ekonominë pyjore Rosek-Rrjoll, ngastra 3, me sipërfaqe 0.02025 ha, në ekonominë pyjore Lugina e Kirit, ngastra 203a, me sipërfaqe pyjore 0,0205 ha, në ekonominë pyjore Pruevos-Sheldi, me sipërfaqe 0.0205 ha. Bashkëlidhur praktikës së shqyrtuar nuk ka planvendosje, nuk ka statusin juridik të pronës, nuk ka axhendë për mbledhje dhe as dëgjese publike, por ka patur kontrata qiraje në periudha të mëparshme për këtë rast. Për dy VKB-ët është dërguar: njoftimi për mbledhje dhe protokoll i mbledhjes së KB datë 21.12.2022, ku në fund theksohet se: *“U hodh në votim miratohet me 28 vota pro, 0 kundër dhe 0 absteni. Në protokoll evidentohet listëprezenca e 32 këshilltarëve pjesëmarrës në mbledhje, të cilët nuk kanë firmosur në fund, përveç Sekretarit të KB.*

Krahas sa më lart, u konstatua se është konfirmuar ligjshmëria e Vendimeve të Këshillave Bashkiak në kundërshtim me nenin 91, pika 4 e Kodit zgjedhor dhe pikës 3 dhe 4 të nenit 3 të Vendimit nr. 9 datë 24.12.202 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të cilat parashikojnë përkatësisht *“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”;**

*“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nën ligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prer”;*

Më konkretisht vihet re se nga **Këshilli Bashkiak Pukë**, janë miratuar vendime në 2 raste për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqeve në favor të subjekteve private për ndërtimin e impianteve për energji eolike, të cilat sipas ligjit në fuqi janë të përjashtuar nga konkurimi public dhe në këtë rast është e pa verifikueshme njohja apo publikimi më parë i procedurës. Nga **Këshilli Bashkiak Vau i Dejës** janë miratuar vendime në 17 raste për dhënie në përdorim prone. Nga **Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz** është miratuar një vendim për dhënie në përdorim prone.

*Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi znj. M. A, znj. F. K dhe znj. H. A.*



**Observacionet e subjektit:** Me shkresë nr. 298/8, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 566/5, datë 02.09.2024, Prefektura Shkodër ka paraqitur komentet si vijon:

1. Nuk është tagër i ligjit organit të Prefektit sipas neneve 16 dhe 17 të hetojë procedurën e mëposhme administrative pas mos konfirmimit të aktit normativ të paraqitur nga Këshilli Bashkiak, përveç asaj që konstatohet gjatë verifikimit në vend. Referuar nenit 15 të ligjit për Prefektin dhe nenit 4 të ligjit për vetëqeverisjen vendore, marrëdhënia mes qeverisjes vendore dhe Prefektit nuk është marrëdhënie varësie administrative.
2. Prefekti sipas urdhrin të tij dhe në varësi të axhendës së institucionit si dhe ngarkesës së Bashkisë, ka kryer disa procese të verifikimit në vend, procedura të cilat kanë sjellë përmirësim të situatës. Nëse një akt i kthyer nga Prefekti nuk rishqyrtohet përsëri nga KB, është në tagrin e tyre për të qenë në një linjë me Prefektin. Procesi i verifikimit në vend kërkon kohë për të arritur një bashkëpunim mes palëve si pasojë e angazhimeve të secilit, me qëllim caktimin e një date për kryerjen e verifikimit.
3. Aktet normative së bashku me dokumentacionin e NJQV depozitohen dhe protokollohen në arkiv sipas detyrës funksionale të punonjësit për mbajtjen e protokollit dhe regjistrin të hyrjes së akteve normative. Procesverbali i çdo mbledhje të këshillit është detyrim për të qenë pjesë e dokumentacionit pasi mungesa e tij nuk shkakton asnjë pasojë juridike. Ky dokument gjendet në sekretari për çdo mbledhje (bashkëlidhur të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të cilat nuk janë kërkuar).
4. Këshilli Bashkiak ka detyrim të realizojë seancat e konsultimit në zbatim të nenit 18 dhe 54 pikat a, dh, e, f, k të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Me ndryshimet ligjore me ligjin 38/2019, në shkronjën e, e cila më parë shprehej "miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve" është bërë ndryshimi si vijon e) miraton tjetërsimin; e1) miraton dhënien në përdorim, për sa më lart nuk kërkohet më seanca konsultimi për dhënien në përdorim pasi në nenin 18 nuk është përfshirë shkronja e1). Ndërkohë neni 77 nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak por e Këshillit të Qarkut. Çdo vendimmarrje është publike dhe transparente pasi ato publikohen në eëb dhe në rast se do të kishte patur ankesa do të pezullohej vendimi nga Bashkia.
5. Dokumentacione si leja, licenca, leje ndërtimi, etj nuk duhet të jenë pjesë e vendimmarrjes së KB, pasi KB merr vendime në zbatim të nenit 9, pika 1.2 gërma c, e ligjit 139/2015, pra në rolin e pronarit. KB nuk është organi që zhvillon procedurën e konkurimit publik, pasi ky proces zhvillohet nga administrata e bashkisë. Administrimi i dokumentacionit është kompetencë e administratës dhe jo Këshillit Bashkiak.
6. Lidhur me VKB nr. 54, datë 23.09.2022, Bashkia Vau i Dejës, dhënia e ndihmës financiare është dhënë bazuar në vendimin e Komisionit të verifikimit në vend, i cili ka konfirmuar se vetëm 32m<sup>2</sup> e banesës është djegur plotësisht. Komisioni verifikon vetëm banesat e dëmtuara dhe jo të gjithë pronën apo pasurinë që posedon z. C dhe nga harta treguese dallohet se ka dy gjurmë të ndryshme ndërtimore. Për këtë arsye ndihma financiare është përlllogaritur për rastin e shkatërrimit total të banesës. Pavarësisht se në certifikatën e pasurisë rezulton një sipërfaqe më e madhe se ajo e deklaruara e banesës, në hartën e pasurisë dallohet qartë që janë dy gjurmë objektesh për të cilën mund ti kërkohet bashkisë një rifreskim për këtë pronë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me observacionet e paraqitura më lart, grupi i auditimit konstaton se ato janë të njëjtat të trajtuara dhe sqaruara tashmë në projekt raportin e auditimit dhe nuk janë paraqitur evidenca apo fakte të reja, të ndryshme nga ato të shqyrtuara. Lidhur me propozimin tuaj për rifreskimin e hartës së pasurisë për pronën e z.C, sqarojmë se ky veprim duhet të ishte ndërmarrë nga Prefektura që në momentin e shqyrtimit dhe para dhënies së aprovimit dhe

pikërisht për këtë arsye, pra për raste të tilla që lenë vend për diskutim, rekomandimet e KLSH propozojnë një thellim të vlerësimit që kryen sektori juridik në shqyrtimin e dokumentacionit të kërkuar dhe jo thjeshtë shqyrtimin formal të tyre sipas rendit nominal përcaktuar në ligj, pasi linden raste si këto kur ka mospërputhje mes dokumentave, aq më tepër në fusha shumë problematike siç janë ato të pronësisë në vendin tonë. Sjellim në vëmendje se Vendimet e Këshillave Bashkiak pa miratimin e Prefektit janë të pa vlefshëm, për këtë arsye vendikti i Prefektit është kyç për vazhdimësinë ose jo të zbatimit të këtyre VKB. Për sa më lart, institucioni i Prefektit duhet të fuqizojë rolin e tij në garantimin e ligjshmërisë dhe transparencës së vendimmarrjes duke bërë gjithmonë një vlerësim të thelluar të dokumentacionit të dërguar dhe kur është e nevojshme edhe të kërkojë dokumentacion shtesë për të krijuar bindjen e arsyeshme.

## IV.GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, Prefektura Shkodër ka realizuar vetëm procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël ose nën vlerën 100,000 lekë, për të cilat konstatohet se dokumentimi bëhet në mënyrë tepër formale pa përcaktuar kritere kualifikimi dhe specifikime teknike, pa shpallje fituesi dhe përcaktimi të vendit dhe datës së kryerjes së dorëzimit të mallrave e shërbimeve, apo pa u shoqëruar me argumentimin e detajuar të nevojës për shpenzime. Po kështu konstatohet se ndër rastet e trajtuara ka copëzim të fondit për blerje të të njëjtës natyrë, kryesisht ato me vlerë nën 100,000 lekë për të cilat është shmangur realizimi i procedurës përkatëse me mjete elektronike, të tilla si shtypshkime, fletëpalosje, broshura etj, apo kancelari dhe bojë printimi. Konkretisht në 4 raste gjatë vitit 2022 dhe në 3 raste gjatë vitit 2023 për shpenzime me objekt printime fletëpalosje, broshura, kartolina, etj, në 2 raste gjatë vitit 2022 për pajisje apo shërbime IT, në 3 raste gjatë vitit 2022 për blerje kancelari, bojëra printimi etj, si dhe në 2 raste gjatë vitit 2023 për punime apo mirëmbajtje godine. Vihet re se ky lloj shpenzimi kryhet masivisht dhe nuk janë shpenzime që lindin nga raste emergjence apo të paparashikuara, por janë procedura të parashikuara që në regjistrin e parashikimeve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikat b, c dhe 3 të nenit 2, pikën 1/c dhe 5 të nenit 11, pikën 3 të nenit 12 dhe nenin 25 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2, faqe 15-20 të Raportit përfundimtar).

**1.1 Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit pranë Prefekturës Shkodër të marrë masa për shmangien e copëzimit të fondeve për kryerjen e shpenzimeve me natyrë të njëjtë, duke planifikuar me saktësi nevojën dhe argumentimin e hollësishëm për të tilla shpenzime dhe kryerjen e prokurimit të tyre në një procedurë të vetme e cila të garantojë konkurrencën dhe transparencën në realizimin e shpenzimeve.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për verifikimin në vend të akteve me karakter normativ rezultoi se, gjatë vitit 2022 Prefektura Shkodër ka realizuar procesin e verifikimit të ligjshmërisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore konkretisht vetëm 1 herë/vit në Këshillin e Qarkut, 3 herë/vit në Bashkinë Shkodër dhe vetëm 2 herë/vit në Bashkitë Fushë Arrëz, Vau i Dejës, Pukë dhe Malësi e Madhe, ndërsa për vitin 2023 vetëm 1 herë/vit në Këshillin e Qarkut dhe Bashkitë Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe dhe vetëm 2 herë/vit në Bashkitë Shkodër, Fushë

Arrëz dhe Pukë, duke rritur riskun e mos garantimit në kohë, nëse këto njësi vendore i kanë depozituar të gjitha aktet normative pranë Prefektit. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura gjatë verifikimeve në vend, konstatohet se vazhdimisht grupi i verifikimit ka tërhequr vëmendjen në raportimet e tyre mbi mungesën e konsultimeve publike gjatë vendimmarrjeve të këshillit, e megjithatë në pjesën më të madhe të konfirmimeve, aktet normative që nuk shoqërohen me dokumentacionin mbi konsultimin publik nuk janë kthyer. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 17 “të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**2.1 Rekomandimi:** Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa për realizimin rregullisht të verifikimeve në vend të akteve normative, duke shqyrtuar me detaje përmbajtjen e tyre dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues që garanton ligjshmërinë e vendimmarrjes, në mënyrë që të shmangen risqet e pavlefshmërisë së tyre.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nga 46 VKB të pa konfirmuara nga Prefekti i Qarkut për periudhën 2022-2023, vetëm në 3 raste janë rikthyer pranë Prefektit Vendimet e rishqyrtuara nga Bashkitë, ndërkohë që për 43 të tjera Prefekti i Qarkut nuk ka marrë masa për ndjekien e mëtejshme të tyre dhe nuk konstatohet të jetë shprehur për këto Vendime as gjatë procesit të verifikimit në vend. Gjithashtu konstatohet se nuk ka një korrespondencë të dokumentuar me Bashkitë nëse këto vendime janë anuluar dhe nuk do të vijohet me miratimin e tyre. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 2 të nenit 17 dhe pikës b/ii të nenit 16 të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**3.1 Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Shkodër në cilësinë e të vetmit institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore, të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj Bashkive në respektimin hap pas hapi të procedurave që ndiqen për konfirmimin e akteve normative, si dhe të mbajë korrespondenca me Bashkitë për dokumentimin e rasteve kur këto të fundit nuk do të vijojnë me miratimin e akteve të refuzuara nga prefekti.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i akteve normative të miratuara nga Prefekti për periudhën objekt auditimi, rezultoi se janë konfirmuar akte normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe konkretisht u konstatuan në 9 raste, procesverbale të mbledhjeve të KB të parregullt ku vihet re se nuk korrespondon numri i anetarëve të KB në listëprezencë me numrin e atyre që kanë votuar apo me numrin e nënshkruesve në fund të procesverbaleve. U konstatuan në 11 raste akte normative për dhënie pronash në përdorim apo heqie nga fondi kullor pa certifikatë pronësie dhe pa statusin juridik të pronës nga AShK, si dhe në 9 raste pa shoqruar me plan vendosje të sipërfaqeve. Po kështu për rastet e vendimmarrjeve mbi pronat u konstatua në 7 raste miratime pa realizuar konsultimin publik me komunitetin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Aneksit 1 pjesë e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut, neni 17 i Ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, dhe pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**4.1 Rekomandimi:** Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga Bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimmarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore kur jepet në përdorim apo shfrytëzim një pasuri publike. Gjithashtu, të kërkohet nga Bashkitë që i gjithë dokumentacioni i dërguar prej tyre të jetë i inventarizuar dhe me listën e dokumentacionit që përmban dosja.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i akteve normative të miratuara nga Prefekti për periudhën objekt auditimi, rezultoi se në 4 raste për dhënien e ndihmës financiare familjeve që kanë pësuar dëmtime në banesa nga fatkeqësi natyrore, janë konfirmuar akte normative në të cilat përcaktohet vlera e dëmeve të përlllogaritur nga komisionet e verifikimit në terren, por nuk është theksuar vlera përfundimtare e dëmshpërblimit financiar që i takon përfituesve, mangësi që duhet të përbënte objekt për rishikim dhe plotësim të VKB-ve me vlerën konkrete të dëmshpërblimit, para konfirmimit nga Prefektura. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 41 dhe me VKM nr.329, datë 16.05.2012 ‘Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, Kreu III, pika 3/ç. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**5.1 Rekomandimi:** Në funksion të shmagies së vendimeve me pasoja financiare, Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa që për rastet e dhënies së ndihmave financiare për familjet e dëmtuara, VKB përkatëse të jenë më të plota dhe konkrete duke cituar shprehimisht vlerën e saktë të dëmshpërblimit financiar që i takon secilit përfitues dhe jo vetëm vlerën totale të dëmeve materiale të shkaktuara.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.Gjetje nga auditimi:** Me shkresë nr. 103/1, datë 10.02.2022, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për VKB nr. 04, datë 26.01.2022, “Për miratimin e vazhdimin të procedurës për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës, të pasurisë nr. 371, ZK3506 e llojit Pa fryt në fshatin Stajkë”. Në relacionin dërguar Këshillit Bashkiak i pa protokolluar, citohet se prona kërkohet për transferim për qëllim zhvillimi ekonomik, duke mos argumentuar as llojin e transferimit që kërkohet, as formën e përdorimit shoqëruar edhe me një plan zhvillimi apo plan biznesi se çfarë është planifikuar të realizohet, si dhe pa cituar numrin rendor të pronës në listën e inventarit. Krahas sa më lart, konstatohet se për propozimin për transferimin e pronësisë nuk dokumentohet të jenë respektuar procedurat e parashikuara nga nenet 35 dhe 37 të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilëve veprimet me pronat shtetërore fillojnë pas përditësimit të plotë të informacionit mbi gjendjen faktike, si dhe mbi të drejtat apo detyrimet që rëndojnë mbi to. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 3 dhe 5 të Ligjit nr. 8744, datë 22.01.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikën 1a, të Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**6.1 Rekomandimi:** Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa për shqyrtimin e kujdeshshëm të dokumentacionit dhe hapave që kanë ndjekur Bashkitë në çështjet e dhënies në përdorim, tjetërsimit apo kalimit në pronësi të pasurive publike, duke mos u mjaftuar vetëm me faktin se baza ligjore

është cituar në vendime dhe relacione, por të verifikohet edhe në mënyrë të dokumentuar se janë ezauruar të gjitha këto përcaktime ligjore, përpara vendimmarrjes për përfundimin e procesit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.Gjetje nga auditimi:** Me shkresë nr. 625/1 datë 07.10.2022, është konfirmuar ligjshmëria dhe vijimi i procedurave ligjore për VKB nr. 54, datë 23.09.2022, “Për dhënie ndihmë financiare familjes së z. J.C që i është dëmtuar banesa si pasojë e rënies së zjarrit”. Nga auditimi rezulton se për vlerësimin e dëmeve, komisioni i ngritur nga Titullari i Bashkisë ka përlogaritur dëmet në orendi, pajisje dhe elektroshtëpiake referuar shkresës nr. 373/1, datë 17.05.2016 të Prefekturës Shkodër, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndërkohë që për vlerësimin e dëmeve të objektit ndërtimor, me relacionin pa protokoll dhe datë, vetëm të një prej anëtareve të komisionit është konkluduar se banesa me sipërfaqe totale prej 32m<sup>2</sup> është e shkatërruar plotësisht dhe për këtë qëllim është proceduar me përcaktimin e kostos mesatare të ndërtimit nga fillimi prej 32,624 lekë/m<sup>2</sup> sipas përcaktimeve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose të tjera shkatuar nga veprimtaria njerëzore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se i dëmtuari ka dorëzuar çertifikatën e pronësisë, ku vihet re se disponon pasurinë me sipërfaqe trualli 200m<sup>2</sup> nga të cilat 174m<sup>2</sup> ndërtesë, nga ku konstatohet mos përputhje me relacionin e hartuar nga anëtarja e komisionit të vlerësimit të dëmeve e cila pohon se ndërtesa e dëmtuar plotësisht ka sipërfaqe totale prej 32m<sup>2</sup> dhe duhet të ndërtohet nga fillimi. Pra nga krahasimi i sipërfaqes së objektit në certifikatë me sipërfaqen që konkludohet e dëmtuar, objekti nuk konsiderohet i dëmtuar totalisht dhe nuk duhet të kryhej vlerësimi sipas kostos mesatare të ndërtimit nga fillimi, por sipas çmimeve në fuqi sipas zërave të ndërtimit që do të përmbante preventivi. Për këtë rast, akti duhet të shqyrtohet me vëmendje të shtuar duke qenë se përfituesi është anëtar i këshillit bashkiak dhe pavarësisht se gjatë votimit citohet se nuk ka marrë pjesë, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Për sa më lart VKB duhet të kthehet për saktësim nëse ndërtesa është dëmtuar e gjitha apo vetëm sipërfaqja prej 32m<sup>2</sup>. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**7.1 Rekomandimi:** Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa për rikthimin për shqyrtim të rasteve të akteve normative të cilat kanë mospërputhje në dokumentacionin e dërguar, si dhe nuk garantojnë siguri të arsyeshme nëse është aplikuar baza e duhur ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 është konfirmuar ligjshmëria e Vendimeve të Këshillave Bashkiak në kundërshtim me nenin 91, pika 4 e Kodit zgjedhor dhe pikës 3 dhe 4 të nenit 3 të Vendimit nr. 9 datë 24.12.202 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, ku në 20 raste janë marrë vendime për dhënie për shfrytëzim apo përdorim të pasurive publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 20-33 të Raportit përfundimtar).

**8.1 Rekomandimi:** Prefektura e Qarkut Shkodër të marrë masa që në të ardhmen, të përfshijë si kriter vlerësimi të ligjshmërisë përcaktimet e Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ me qëllim shmangien e vendimmarrjeve që bien ndesh me këto përcaktime,

duke rikujtuar Bashkitë, si dhe duke mos pranuar për shqyrtim asnjë akt normativ, vendimmarrja e të cilit nuk ka lindur nga nevoja të rasteve të emergjencave apo parashikimeve të tjera në ligj.

**Në vijimësi**

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi që gjatë vitit 2022 Prefektura e Qarkut Shkodër ka likujduar Vendimin gjyqësor nr. 234, datë 17.06.2022 të Gjykatës së Apelit në vlerën 982,464 lekë, për largimin nga puna të një punonjësi, me pasojë efekt financiar negativ në këtë vlerë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.1, faqe 9-15 të Raportit përfundimtar).*

**1.1.Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Shkodër të marrë masa që në të ardhmen, vendimet që lidhen me largimin nga puna të punonjësve të jetë të argumentuar, të mbështetur në ligj, si dhe të respektojë afatet e njoftimit për largimin.

**Në vijimësi**

## **C. MASA DISIPLINORE**

**C.1** Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Shkodër, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore - “Vërejtje”, si më poshtë:

1. znj. F.K, Sekretare e Përgjithshme, për mangësitë e konstatuara në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga Këshillat Bashkiak për ligjshmërinë e vendimeve të marra prej tyre;
2. znj. H.A, përgjegjëse e sektorit juridik, për mangësitë e konstatuara në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga Këshillat Bashkiak për ligjshmërinë e vendimeve të marra prej tyre.

**C.2** Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 5 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin” dhe Urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020 të Ministrisë të Brendshme “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Prefektit të Qarkut, si dhe aneksin mbi procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, i rekomandojmë Ministrisë të Brendshme, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për Prefektin e Qarkut Shkodër, znj. M.A për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të

dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të germës a), nenit 8 dhe nenin 16 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, trajtuara gjerësisht në faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**